



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.451/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyndi Haziri kryesues, Rrustem Thaqi dhe Burim Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur lidhur me ankesen e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e evidentuar si: Anr.451/2021, e datës 14.02.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë kundër subjektit politik, Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponzorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore i Shqiptohet gjobë, në lartësi prej 500.00 (pesqind) euro, dhe Detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënrim te dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesen Anr.451/2021, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, në të cilat pretendon se përmes Facebook-ut, në llogarinë zyrtare të sekretarit të rinisë së këtij subjekti, Endrit Zabergja, ka bërë fushatë në rrjetin social Facebook, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjen në ankesë të ofruar të subjektit Nisma Socialdemokrate thekson se sa i përket ankesës së Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me thyerjen e heshtjes zgjedhore nga sekretari i Rinisë së Nismës Socialdemokrate, Endrit Zabergja, nga se i njëjti ka bërë një postim me të cilin ka bërë thirje për votim të Nisma-së në rrjetin social Facebook, konstatojnë së Endrit Zabergja nuk është sekretar i rinisë dhe as që ka ndonjë pozitë menaxhuese në nivel qëndror të Nisma-së. Po ashtu kanë theksuar se pas kontaktit me zotrin Zabergja postimi në fjalë është hequr nga Facebook-u, ku si provë kanë sjellur printimin e faqes nga Facebook-u ku ka qenë e postuar fotoja.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se si Endrit Zabërgja nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, gjatë ditës së votimit në rrjetin e tij social Facebook ka postuar një fotografi duke bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet subjekti i tyre politik, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform dispozitës në nenit 8, par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, verifikoj pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, përfaktin se në llogaritë e Facebook-ut ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike aktive, të cilat promovojnë subjektin politik Nisma Socialdemokrate dhe kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj PZAP, duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Nisma Socialdemokrate, është përgjegjëse për veprimet e tyre, pasi që me veprimet e lartëcekura ka shkelur nenin 36, paragrafi 1, pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rr Ethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Nisma Socialdeomkrate ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme,
- Faktin se shkelja rezulton të jetë bere nga një mbështetës,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përvèç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përbahen nga veprimet që bien ndesh me rregullativën ligjore, që te mos cenohet heshtja zgjedhore duke siguruar klimë të qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënim i nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti

shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjeter e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënavë të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.451/2021 më datë 15.02.2021

Kryesues i Panelit

Zyjdi Haziri



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.1 e LZP-së